

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI I SHOQËRISË  
Lux4heritage SHPK**

**THEMELIMI**

**Neni 1  
Ortaku themelues**

- 1.1 Shoqëria Lux4heritage SHPK themelohet nga Ortaku i Vetëm **Z. Dorian Husi**, shtetas shqiptar, lindur më 27.09.1982, në Tirane, banues në Njësia Administrative Nr. 5, Rruga Ibrahim Rugova, Tiranë, mbajtës i Pasaportes me Nr. B14680195 dhe Nr. Personal I20927052Q.

**EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

**Neni 2  
Emërtimi**

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është **Lux4heritage**.

**Neni 3  
Forma ligjore**

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4  
Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimitarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

**Neni 5  
Kohëzgjatja e veprimitarisë**

- 5.1 Veprimitaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").
- 5.2 Afati i veprimitarisë së shoqërisë është per një afat te papercaktuar.

**Neni 6**  
**Selia**

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: **Njesia administrative Nr. 2, Rr. Papa Gjon Pali II (ish Lek Dukagjini), Pallati 11/1,kati 6, apartamenti nr.20 – Tirane, Shqiperi.**
- 6.2 Administratori i shoqërise mund të vendosë të hapë degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj ose mund të crregistroje ato ekzistuese sipas ligjeve ne fuqi.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijojen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashte saj me vendim te Administratorit te shoqërisë.

**Neni 7**  
**Emblema. Vula**

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemët dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përbajnjë emblemën dhe vulën e saj.

**Neni 8**  
**Objekti**

- 8.1 Objekti i veprimitarisë së Shoqërisë është: **Sherbime te menaxhimit, administrimit dhe mirembajtjes se zakonshme te pasurive luajshme e te paluajtshme. Sherbime te ndermjetesimit ne shitjen dhe blerjen e pasurive te luajshme e te paluajtshme; Dhenie dhe marrje me qira te pasurive te luajshme e te paluajtshme; cdo aktivitet tjeter qe lidhet me pasurite e paluajtshme.**
- 8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 9**  
**Kapitali**

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **100'000 ( njeqind mijë) Leke.**
- 9.2 Ortaku i Vetëm zoteron 1 (një) kuote, e cila eshte e barabarte me vleren e kapitalit.
- 9.3 Kapitali është shlyer tërësisht.

**Neni 10**

### **Transferimi i kuotave. Kufizimet.**

- 10.1 Kuotat mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese.
- 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Ortakut të Vetëm.

### **Neni 11 Rritja e kapitalit**

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakut të Vetëm.

### **Neni 12 Zvogëlimi i kapitalit**

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpëra marrjes së vendimit nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin ortakut të vetëm raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë.

### **ORGANET E SHOQËRISË**

### **Neni 13 Vendimet e ortakut të vetëm**

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Ortaku i Vetëm i saj.
- 13.2 Vendimet e Ortakut të Vetëm përfshijnë kriesisht:
  - Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
  - Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe percaktimin e shpërbllimit per ta;



- Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe percaktimin e shpërblimit per ta;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Transformimin e shoqërisë në formën e tjera.

**Neni 14**  
**Administrimi**

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakut të Vetëm.
- 14.3 Administratori i shoqërisë eshte **Z. Dorian Husi**, shtetas shqiptar, lindur më 27.09.1982, në Tirane, banues në Njësia Administrative Nr. 5, Rruga Ibrahim Rrugova, Tiranë, mbajtës i Pasaportes me Nr. B14680195 dhe Nr. Personal I20927052Q.
- 14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
  - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënet me të tretë personalisht ose me përfaqësim;
  - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
  - Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
  - Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj;
  - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, insitacione apo entitete publike ose private;
  - Të lidhë për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
  - Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm përmbarëvajtjen e biznesit në Shqipëri;
  - Të vendos për ndryshimin e selisë së shoqërisë;
  - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
  - Të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm përbiznesin e shoqërisë në Shqipëri.
- 14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Ortakut të Vetëm.



- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Ortakut të Vetëm.
- 18.2 Me vendimin e Ortakut të Vetëm caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedurë, Ortaku i Vetëm do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.

**Neni 19**  
**Mosmarrëveshjet**

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

**Neni 20**  
**Klauzolë myllëse**

- 20.1 Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë, datë 14.06.2023.

Lux4heritage SHPK

Ortaku i Vetëm:

Dorian Husi



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "DORIAN HUSI".